

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizrena <b>"UKSHIN HOTI"</b>	
Pranuar më dt.	09.03.2023
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-134



**AICS** Albanian Institute  
of Cultural Studies

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI  
PËR AKTIVITETE DHE PROJEKTE SHKENCORE TË PËRBASHKËTA**

**NDËRMJET**

**UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" PRIZREN  
KOSOVË**

**DHE**

**INSTITUTIT "ALBANIAN INSTITUTE OF CULTURAL STUDIES"  
PRISHTINË**

Universiteti "*Ukshin Hoti*" Prizren (UPZ), me seli në Rr. Shkronjat 1, 20000 Prizren, Kosovë, përfaqësuar nga Rektori i tij, Prof. Asoc. Dr. Samedin Krrabaj dhe *Albanian Institute of Cultural Studies (AICS)*, me adresë: Rruga, "*Ukë Bytyçi*", nr.44, Prishtinë 10000, Kosovë, i përfaqësuar nga drejtuesi, Dr. Elona Gjata, me synimin për të forcuar bashkëpunimin në veprimtari të përbashkëta shkencore në fushën gjuhës, letërsisë, kulturës, filologjisë në realizimin e projekteve të përbashkëta për të kontribuar në zhvillimin e studimeve albanologjike shqiptare, brenda dhe jashtë vendit. Duke pranuar rëndësinë e partneritetit të bazuar në parimet e pjesëmarrjes të mirës së përbashkët dhe reciprocitetit në varësi të disponueshmërisë së burimeve të ofruara për të përmbushur bashkëpunimin ndërmjet Palëve ranë dakord për sa vijon:

**Neni 1  
Qëllimet**

- Qëllimet kryesore të këtij memorandumi bashkëpunimi janë:
- Krijimi i kornizës për bashkëpunim në fushën e gjuhës, letërsisë, kulturës, filologji;
  - Përpjekjet për të hartuar projekte të përbashkëta sipas fushave të lartpërmendura;
  - Disponimin për të hyrë në thirrje të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare për projekte të ndryshme;
  - Lehtësimin e partneritetit të palëve në fushën e gjuhës, letërsisë, kulturës, filologjisë, kurdo që është e përshtatshme.

## Neni 2 Fushat e bashkëpunimit

### 2.1 Fushat kryesore të bashkëpunimit sipas këtij Memorandumi përfshijnë:

- Shkëmbimi i informacionit rreth strategjive dhe bashkëpunimit të Palëve në fushën e gjuhës, letërisë, kulturës dhe filologjisë;
- Vizita dhe shkëmbime të stafit shkencor dhe studentëve të Universitetit "*Ukshin Hoti*" dhe stafit të *Albanian Institute of Cultural Studies* në veprimtari shkencore brenda dhe jashtë vendit;
- Shkëmbimi i materialeve dhe botimeve shkencore; realizimi i botimeve shkencore;
- Promovimi i bashkëpunimit në fushat e sipërmendura;
- Zhvillimi i veprimtarive të cilat janë reciprokisht të dobishme për të dyja palët;
- Angazhimi i stafit në zhvillimin kërkimor-shkencor sipas disiplinave të interesit shkencor; publikime të ndryshme shkencore;
- Kërkim dhe zhvillim bashkëpunues me përfitim reciprok. Çdo publikim që rezulton nga hulumtimi bashkëpunues do të mbajë emrat e anëtarëve të ekipit nga të dy institucionet
- Diskutimi i projekteve të ndryshme me interesa të përbashkëta, duke përfshirë mundësinë e marrëveshjeve të shkallës së dyfishtë;
- Ftesa për ligjërata të studiuesve të ndryshëm në auditorin e Fakultetit Filologjik të Universitetit "*Ukshin Hoti*" me kosto të mbuluara shpenzimi;

### 2.2 Bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve do të zhvillohet në fushat e mëposhtme:

- Gjuhë
- Letërsi
- Kulturë
- Filologji

### 2.3 Një plan kohor për zhvillimet progresive do të bihet dakord mes dy institucioneve.

### 2.4 Secila palë cakton një person kyç kontakti që të jetë përgjegjës për ekzekutimin e këtij memorandumi.

#### ➤ Personi kryesor i kontaktit për UPZ:

- Koordinator akademik: Prof. asoc. dr. Arsim Susuri, Telefon: +383 44 254 183, email: [arsim.susuri@uni-prizren.com](mailto:arsim.susuri@uni-prizren.com)
- Kontakt Administrativ: Përparim Avdullahu, Udhëheqës i Divizionit për Marrëdhënie me Jashtë, Telefon: +383 44 306 748, email: [perparim.avdullahu@uni-prizren.com](mailto:perparim.avdullahu@uni-prizren.com), uebfaqja: <https://www.uni-prizren.com/en/>

- Personi kryesor i kontaktit për AICS:
  - Koordinator akademik: Dr. Elona Gjata, telefon: 0038349869963, email: elona-gjata@hotmail.com; aics.rks@gmail.com ;
  - Kontakti administrativ: Kron Krasniqi, telefon: 0038345274867, email: kronkrasniqi97@gmail.com

### Neni 3

#### Mekanizmat dhe format e bashkëpunimit

Mekanizmi kryesor i bashkëpunimit është ky Memorandum.

Palët ose personat e autorizuar janë në gjendje të lidhin marrëveshje për veprimtari shkencore dhe projekte të përbashkëta, të cilat gjejnë zbatim me anë të neneve të këtij Memorandumi.

Format e mëposhtme të bashkëpunimit janë të zbatueshme sipas këtij Memorandumi dhe marrëveshjeve të lidhura në këtë kuadër:

- Suport në promovimin e punëve shkencore në fushën e gjuhës, letërsisë, kulturës dhe filologjisë me ndihmesë në Albanologji;
- Organizimi i punëtorive praktike, simpoziumeve dhe konferencave bazuar në interesin e përbashkët në fushën e gjuhës, letërsisë, kulturës dhe filologjisë;
- Shkëmbimi i informacionit në fushën e sipërpërmendura;
- Marrëveshjeve të dyfishta dhe projekteve shkencore dhe kërkimore.

### Neni 4

#### Mekanizmat dhe format e financimit

Bashkëpunimi në fushën e gjuhësisë, letërsisë, kulturës dhe filologjisë në ndihmë të Albanologjisë Shqiptare në kuadrin e këtij Memorandumi do të mbështetet nga mekanizmat dhe format e duhura të financimit për të cilat Palët bien dakord në marrëveshjet plotësuese dhe programet e punës.

Nëse burimet financiare që i atribuohen Zyrës së Mobilitetit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar për këtë qëllim nuk do të jenë të disponueshme, shkëmbimi mund të bëhet vetëm mbi një bazë pagese personale.

### Neni 5

#### Kontrolli i të drejtave të pronësisë intelektuale

Të dyja palët garantojnë mbrojtjen e duhur dhe efektive dhe shpërndarjen e barabartë të të drejtave mbi pronësinë intelektuale që mund të lindin si rezultat i bashkëpunimit të përbashkët në kuadrin e këtij Memorandumi sipas ligjeve kombëtare dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të vendeve të cilave Palët bëjnë pjesë.

Kushtet e blerjes, ruajtjes dhe përdorimit të të drejtave të pronësisë intelektuale në lidhje me produktet dhe (ose) proceset e mundshme që mund të jenë rezultat i këtij memorandumi duhet të jenë objekt i marrëveshjeve shtesë dhe programeve të punës në kuadër të bashkëpunimit.

### Neni 6 Konkluzioni



Memorandumi hyn në fuqi nga data e nënshkrimit dhe është i vlefshëm brenda 5 (pesë) viteve. Në rast se njëra nga Palët nuk do të informojë një Palë tjetër për qëllimin e saj për të mos zgjatur këtë Memorandum, ai do të zgjatet automatikisht në fund të afatit fillestar për një mandat tjetër prej 5 (pesë) vjetësh.

Përmbajtja e këtij Memorandumi mund të ndryshohet me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet Palëve.

Çdo Palë në çdo kohë mund të informojë një Palë tjetër për qëllimin e saj për të përfunduar këtë Memorandum. Në këtë rast, përfundimi do të hyjë në fuqi 6 (gjashtë) muaj pas datës së njoftimit dhe nuk do të përfshijë aktivitete të vazhdueshme në kuadrin e bashkëpunimit, përveç rasteve kur Palët kanë vendosur reciprokisht ndryshe.

Palët do të angazhohen për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi përmes negociatave të drejtpërdrejta.

Ky memorandum është nënshkruar në mënyrë të rregullt në 2 kopje në Shqip, të gjitha tekstet janë njëloj autentike.

<p style="text-align: center;"><b>PËR</b> <b>UNIVERSITETIN "UKSHIN HOTI"</b> <b>PRIZREN</b></p> <p style="text-align: center;"> Rektori <b>Prof. asoc. dr. Samedin KRRABAJ</b></p> <p style="text-align: center;">PRIZREN 10.03 / 2023</p>	<p style="text-align: center;"><b>PËR</b> <b>ALBANIAN INSTITUTE OF</b> <b>CULTURAL STUDIES</b></p> <p style="text-align: center;"> DREJTUESI <b>Dr. Elona Gjata</b></p> <p style="text-align: center;">PRISHTINË/ 10.03 /2023</p>
---	---